



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



# **LICENCË PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES**

**DHËNË :**

**KOMPANISË KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE  
FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE – SH.A.**

**Numri i Licencës: ZRRE/Li/Tr\_06/17**

**Prishtinë, 13 prill 2017**

## PËRMBAJTJA

Neni 1	Qëllimi .....	3
Neni 2	Përkufizimet .....	3
Neni 3	Të drejtat dhe detyrimet.....	4
Neni 4	Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.....	5
Neni 5	Ngarkesat e Shpërndarjes dhe Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve...	6
Neni 6	Ndalimi i Diskriminimit.....	6
Neni 7	Kodi i Shpërndarjes .....	6
Neni 8	Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodin e Matjes, dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji .....	6
Neni 9	Funksionimi i Sistemit të Shpërndarjes.....	7
Neni 10	Planet Zhvillimore .....	7
Neni 11	Blerja Ekonomike e Aseteve dhe Shërbimeve .....	8
Neni 12	Regjistrimi dhe jetërsimi i Aseteve Relevante .....	8
Neni 13	Furnizimi me Pajisje Matëse dhe Shërbimet e të Dhënave .....	9
Neni 14	Identifikimi dhe Parandalimi i Shfrytëzimit të Paautorizuar i Energjisë Elektrike .....	10
Neni 15	Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes .....	10
Neni 16	Standardet e Sigurisë së Operimit .....	11
Neni 17	Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përbushjes së aktiviteteve të Operatorit të Shpërndarjes.....	11
Neni 18	Qasja në Tokë dhe/ose në Ndërtesa.....	12
Neni 19	Kufizimi në Përdorimin e Informatës së Caktuar .....	12
Neni 20	Dhënia e Informatave Operatorit të Sistemit të Transmetimit .....	13
Neni 21	Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.....	13
Neni 22	Përgjegjësia ligjore dhe menaxheriale.....	13
Neni 23	Rregullat e Tregut.....	14
Neni 24	Shëndeti dhe Siguria .....	14
Neni 25	Puna .....	14
Neni 26	Obligimi i Sigurimit .....	15
Neni 27	Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit .....	15
Neni 28	Obligimet e Shërbimit Publik .....	15
Neni 29	Sigurimi i Informacioneve ndaj Rregullatorit .....	15
Neni 30	Taksat .....	16
Neni 31	Vazhdimi, Modifikimi Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës .....	16
Neni 32	Masat Administrative dhe Gjobat.....	16
Neni 33	Zgjidhja e Kontesteve .....	17
Neni 34	Hyrja në fuqi.....	17

## Neni 1 Qëllimi

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji** - ZRRE (në tekstin e mëtejshëm “Rregullatori”), në pajtim me autoritetin e dhënë me Nenin 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Ligjin për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081), Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017) nëpërmjet kësaj, në seancën e datës 13 prill 2017 ndryshon (modifikon) Licencën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes e transferuar më 18 Korrik 2012 nga Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A – Divizioni i Shpërndarjes (me numër transferi ZRRE/Li/Tr\_06/12) në ndërmarrjen “**Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike**” SH.A, tani me numër licence: **ZRRE/Li/Tr\_06/17**, adresa: **Rr. “Nëna Terezë” Nr 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës**, (në tekstin e mëtejshëm “i licencuari”).
2. Ndryshimi/modifikimi i kësaj licence vjen si rezultat i ndryshimeve të Legjislacionit primar të sektorin të Energjisë: Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085, i cili ka hyrë në fuqi në gusht 2016); Ligjit për Gazin Natyror (Ligji Nr. 05/L-082, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); si dhe Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017, e cila ka hyrë në fuqi me 31 mars 2017).

## Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptimin si në vijim:
  - a) **Program i Pajtuëshmërisë** – program që kërkohet të përgatitet nga i Licencuari dhe të aprovohet nga Rregullatori, sipas Nenit 27 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
  - b) **Plan Zhvillimor** - çdo plan zhvillimor që do të përgatitet nga i Licencuari, sipas Nenit 10 të Ligjit për Energjinë dhe Nenit 28 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
  - c) **Vit financiar** - periudha prej 1 janar deri më 31 dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.
  - d) **Shoqëri Aksionare** - çdo kompani e definuar si e tillë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
  - e) **Legjislacion** - Ligji për Energjinë (Nr.05/L - 081), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (nr. 05/L - 084), Ligji për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L - 085) si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.
  - f) **Rregulla të Tregut** - normat që rregullojnë tregtimin e energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve në treg dhe lidhjet ndërmjet palëve të tregut të energjisë, Operatorit

të Tregut dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, me qëllim të ruajtjes së balancit fizik në treg.

g) **Kodet** - rregullat që synojnë të vendosin standardet minimale të dizajnit teknik, kërkesave dhe standardeve operative, si dhe kushteve komerciale për aktivitete relevante në sektorin e energjisë, dhe për të cilat Ligji obligon që të dorëzohen për aprovim në Rregullator.

h) **Person i ndërlidhur** - çdo ndërmarrje në pronësi apo e kontrolluar nga një ndërmarrje tjetër, siç është përcaktuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, në fuqi.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptimin si shprehjet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.

### Neni 3

#### Të drejtat dhe detyrimet

1. I licencuari do të gëzojë të drejtat dhe do të marr përsipër përgjegjësitë e caktuara në ligjet, rregulloret, rregullat dhe kodet në fuqi, përfshirë ato të përcaktuara në Nenin 28 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe, ndër të tjera, duhet të:

1.1. operoj, mirëmbaj dhe zhvilloj sistemin e shpërndarjes në mënyrë efikase, ekonomike dhe të koordinuar siç është përcaktuar në këtë Licencë;

1.2. siguroj disponueshmëri afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen, operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e energjisë elektrike sipas kushteve të tregut, duke i kushtuar kujdes të duhur mjedisit dhe efqiencës së energjisë;

1.3. lehtësoj kyçjen dhe shfrytëzimin e sistemit në mënyrë jo diskriminuese, në pajtueshmëri me ligjet, kodet dhe rregullat në fuqi;

1.4. veproj në pajtueshmëri me Rregullat e Tregut.

2. Territori që mbulohet nga kjo licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.

3. Të Licencuarit mund të mos i jepet licenca për ndonjë aktivitet tjetër të energjisë elektrike, përveç nëse i licencuari vepron në përputhje me kërkesat e pavarësisë dhe shturjes të Nenit 27 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

4. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me dispozitat dhe kushtet e specifikuar në këtë licencë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe ligjet, rregulloret, rregullat dhe kodet e tjera në fuqi.

## Neni 4

### Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. I Licencuari do të përgatis Pasqyrat Financiare Vjetore në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, të nxjerrë nga Rregullatori dhe do t'i dorëzojë Rregullatorit një kopje të Pasqyrave Financiare të audituara, brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar. Në rast se i licencuari për arsye objektive nuk mund të përgatis këto pasqyra brenda tre (3) muajve, atëherë jo më vonë se 15 mars, i licencuari duhet të kërkojë nga rregullatori shtyrje afati, por jo më vonë se 30 prill të vitit aktual, për dorëzim të këtyre pasqyrave.
2. Llogaritë e brendshme duhen të jenë të ndara për aktivitetet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nga llogaritë e tjera të tij për aktivitetet tjera, sikur këto aktivitete të kryheshin nga ndonjë ndërmarrje tjetër.
3. I Licencuari do të dorëzojë në Rregullator Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara nga një auditor i pavarur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar. Auditori duhet të verifikoj që kërkesat e lidhura me ndalimin e ndër-subvencioneve dhe diskriminimit në Nenet 5 dhe 6 të kësaj licence janë përmbushur.
4. I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për aktivitetin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në tërësi, dhe sipas kërkesës së Rregullatorit, do t'i dorëzojë në formën dhe datën e specifikuar nga Rregullatori. Kontabiliteti rregullativ do të jetë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, i cili ndër të tjera mund të specifikoj:
  - 4.1. formën e deklaratave/regjistrave të kontabilitetit rregullativ, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në, llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, aseteve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë biznes tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis bizneseve të konsoliduara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe ndonjë biznesi tjetër;
  - 4.2. natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave të kontabilitetit rregullativ, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, aseteve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara;
  - 4.3. parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
5. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazën e ngarkesës, shpërndarjes ose alokimit që janë përdorur në vitin financiar paraprak, përveçse nëse Rregullatori nxjerr më parë

udhëzimin relevant ose jep aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.

6. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga Rregullatori dhe legjislacioni në fuqi.

#### **Neni 5**

##### **Ngarkesat e Shpërndarjes dhe Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve**

1. Të gjitha ngarkesat e vendosura nga i Licencuari për kryerjen e aktiviteteve të licencuara, duhet të vendosen në përputhje me Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe ndonjë metodologji të zbatueshme të ngarkesës të miratuar nga Rregullatori.
2. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të licencuara të shpërndarjes, i Licencuari duhet të sigurohet që ngarkesat për kyçje apo shfrytëzim të sistemit nuk ngritën apo ulen si rezultat i dhënies apo marrjes së ndonjë ndër-subvencioni (direkt apo të tërthortë) nga ose në interes të ndonjë aktiviteti tjetër të të licencuarit apo nga ndonjë person i ndërlidhur, korporatë apo ndonjë person tjetër juridik ose fizik.

#### **Neni 6**

##### **Ndalimi i Diskriminimit**

Gjatë vendosjes së çmimeve që do t'u ngarkohen përdoruesve të sistemit të të Licencuarit, i Licencuari nuk duhet të ketë preferencë ndaj ndonjë përdoruesi apo kategorie të përdoruesve, nuk duhet padrejtësisht të ushtroj diskriminim ndaj ndonjë përdoruesi apo kategorie të përdoruesve dhe nuk duhet që në mënyrë të paarsyeshme të vendos kushte dhe afate të vështira për kyçje apo përdorim të sistemit.

#### **Neni 7**

##### **Kodi i Shpërndarjes**

I Licencuari duhet të ndërmarr të gjithë hapat brenda autoritetit të tij që të siguroj se Kodi i Shpërndarjes në fuqi në kuadër të kësaj licence (data e dhënies) mbetet një kod që përputhet me kërkesat e Nenit 28 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 8**

##### **Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodin e Matjes, dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji**

I Licencuari do të veproj në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

## **Neni 9**

### **Funksionimi i Sistemit të Shpërndarjes**

1. I Licencuari duhet të planifikoj, operoj, mirëmbaj dhe zhvilloj sistemin e shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin, kodet teknike dhe rregullat në fuqi.
2. I Licencuari është përgjegjës për funksionimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. I Licencuari është i obliguar të ofrojë afatet për kyçje dhe përdorimin e sistemit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Për çdo kontest që del nga kyçja në sistemin e shpërndarjes apo përdorimi i tij, do të zbatohen dispozitat e Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga Rregullatori.
4. I Licencuari do të siguroj qasje jo diskriminuese për shfrytëzuesit e sistemit ose kategoritë e shfrytëzuesve të sistemit, në veçanti duke mos i favorizuar Vartësit apo Aksionarët, dhe t'u siguroj atyre informatat që ju nevojiten për qasje efikase në sistem, në përputhje me Nenin 28 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
5. I Licencuari duhet t'i jap prioritet dispeçimit të gjenerimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimi, në varësi të ndonjë kufizimi të specifikuar për qëllime të sigurisë së sistemit nga Kodi i Transmisionit dhe Kodi i Shpërndarjes.
6. I Licencuari do të publikoj në faqen e tij zyrtare elektronike Metodologjinë Tarifore për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Metodologjinë e Taksave për Kyçje, të aprovuar nga Rregullatori poashtu edhe Kodet informatat dhe të dhënat e kërkuara nga Ligji për Energjinë Elektrike.

## **Neni 10**

### **Planet Zhvillimore**

1. Sipas Nenit 10 të Ligjit për Energjinë dhe Nenit 28, nën-paragrafët 1.25 deri në 1.28 të Ligjit për Energjinë Elektrike, i Licencuari do të hartoj dhe publikojë Planin Zhvillimor afatmesëm dhe afatgjatë të Sistemit të Shpërndarjes, që mbulojnë periudhën prej së paku pesë (5) vite respektivisht dhjetë (10) vite.
2. I Licencuari do të rishikoj planin zhvillimor afatgjatë çdo vit, në bashkëpunim me OST, për të siguruar që informacioni i paraqitur në planin zhvillimor, të vazhdojë të jetë i saktë në të gjithë aspektet materiale. Propozimet eventuale për plotësimin apo ndryshimin e planit zhvillimor do të dorëzohen në Rregullator për aprovim.

## Neni 11

### Blerja Ekonomike e Aseteve dhe Shërbimeve

1. I Licencuari do të kontrakttoj dhe siguroj asetet dhe shërbimet që janë të nevojshme për t'i mundësuar atij që të kryej detyrimin e tij sipas Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Shpërndarjes. Kontraktimet e tilla do të bëhen në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, dhe legjislacionin tjetër relevant në fuqi në Kosovë.
2. Gjatë kontraktimit për sigurimin e asetëve dhe shërbimeve në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni, i Licencuari do të blej ose do të siguroj në ndonjë formë tjetër ato asete dhe shërbime nga burimet më ekonomike që ka në dispozicion.
3. Duke marrë parasysh burimet ekonomike që ka në dispozicion, i Licencuari duhet të ketë parasysh sasinë, natyrën, shumëllojshmërinë, numrin dhe sigurinë e asetëve të tilla dhe shërbimeve që në atë kohë kanë qenë në dispozicion për blerje ose për përvetësim tjetër, dhe sipas nevojave të tij që t'i mundësojë atij që t'i kryej obligimet e tija sipas kësaj licence, Kodit të Shpërndarjes dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

## Neni 12

### Regjistrimi dhe tjetërsimi i Aseteve Relevante

1. I Licencuari do të përgatis dhe do të mbaj një regjistër të të gjithë asetëve relevante dhe do t'i dorëzojë Rregullatorit me çdo ndryshim në regjistër jo më vonë se 31 Janar të çdo viti.
2. I Licencuari nuk do ta shes apo heq dorë nga kontrolli funksional mbi ndonjë aset relevant, nëse kjo do të ndikonte në aftësinë e tij për të kryer obligimet e tij. Në rast kur i Licencuari dëshiron të shes asetet, apo pasuritë e tjera që përdoren në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, ku vlera e tyre tejkalon shumë (njëqind mijë euro) 100,000.00 €, i Licencuari obligohet që ta njoftoj Rregullatorin me shkrim. I Licencuari mund ta bëjë tjetërsimin e ndonjë aseti të tillë vetëm pas miratimit me shkrim nga Rregullatori.
3. Në këtë Nen:

**"Tjetërsim"** – çdo shitje, transferim, dhurim, dhënie me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizim mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor) ose ndonjë ngarkesë tjetër si dhe lejimin e ndonjë ngarkese ndaj një aktivitetit tjetër të të Licencuarit ose pale të tretë.

**"Aset relevant"** nënkupton:

- a) çdo pajisje e Sistemit të Shpërndarjes që shfrytëzohet nga i Licencuari për të kryer funksionet e veta siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij Neni;
- b) çdo interes ligjor ose përfitues mbi tokën dhe/ose ndërtesat në të cilat janë vendosur të sipërpërmendurit, dhe/ose që shfrytëzohet nga i Licencuari për të kryer



funkcionet që përcaktohen në këtë Licencë; dhe  
c) çdo pronësi intelektuale.

### Neni 13

#### Furnizimi me Pajisje Matëse dhe Shërbimet e të Dhënave

1. I Licencuari, në përputhje me Nenet 53 dhe 54 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodin e Matjes, Rregullat e Tregut të OSSH-së, dhe sipas kërkesës së konsumatorëve, furnizuesve dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, do të siguroj këto shërbime:
  - 1.1 furnizimin me Pajisje Matëse;
  - 1.2 instalimin, matjen, testimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve matëse;
  - 1.3 shërbimet për grumbullimin e të dhënave;
  - 1.4 transferin e të dhënave, procedimin e të dhënave dhe shërbimet e grumbullimit të të dhënave.
2. I Licencuari mund t'ia besoj leximin e njehsorëve furnizuesve ose kontraktorëve të tjerë. Në këtë rast, i Licencuari duhet të sigurohet se entiteti i kontraktuar për lexim të njehsorëve duhet të performoj lexim të rregullt dhe të saktë të njehsorëve, në pajtim me Kodin e Matjes.
3. Kur, në përputhje me Rregullën për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, Furnizuesi i Mundësisë së Fundit i ka lëshuar një udhëzim të Licencuarit lidhur me nevojën për të lexuar matësit në një lokacion specifik të konsumatorit, i Licencuari duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar se leximet e tilla të njehsorëve janë realizuar dhe se leximet i janë dërguar Furnizuesit të Mundësisë së Fundit brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga një udhëzim i tillë.
4. Rregullatori mund të kërkoj nga i Licencuari të grumbulloj dhe mbaj informata, të dhëna dhe dokumente në përputhje me Nenin 18 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Në këtë Nen:

**“Shërbimet e të dhënave”** - mbledhja e të dhënave, procesimi i të dhënave, shërbimet e grumbullimit të të dhënave dhe furnizimi me të dhëna;

**“Transferi i të dhënave”** - transferimin e të dhënave të papërpunuara dhe të dhënave të përpunuara mbi matjet tek ndërmarrje tjera të licencuara për energji, siç kërkohen për llogaritjet përfundimtare dhe për qëllime të faturimit;

**“Përpunimi i të dhënave”** - shërbime që përmbajnë shqyrtimin, vlefshmërinë, vlerësimin e të dhënave nga leximi i njehsorit në lidhje me konsumimin e energjisë elektrike në

ndërtesat që furnizohen me energji elektrike përmes njehsorit dhe krijimin, shqyrtimin dhe vlefshmërinë e të dhënave në lidhje me konsumimin e energjisë elektrike në ndërtesat që nuk furnizohen me energji elektrike përmes njehsorit; dhe

*“Grumbullimi i të dhënave”* - mbledhja e të dhënave nga leximi i njehsorëve, krahasimi (sistemimi) dhe dërgimi i këtyre të dhënave tek Operatori i Tregut.

#### **Neni 14**

##### **Identifikimi dhe Parandalimi i Shfrytëzimit të Paautorizuar i Energjisë Elektrike**

1. I Licencuari do të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme me qëllim të identifikimit dhe parandalimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, dëmtimi të ndonjë pajisje apo njehsori dhe shkeljeve të tjera të përcaktuara me Nenin 39 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
2. I Licencuari duhet të kryej analizën e humbjeve siç kërkohet me Nenin 28, nën paragrafët 1.24 dhe 1.25 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe të dorëzoj në Rregullator, jo më vonë se 31 dhjetori i secilit vit financiar, planin e tij vjetor për menaxhimin dhe reduktimin e humbjeve të tilla në vitin/et në vijim.
3. I Licencuari është i obliguar të zbatoj Procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, dhe do të ndërmerr masat parandaluese për të mbrojtur të hyrat e OSSH-së.
4. Me kërkesë të Licencuarit apo të Rregullatorit Procedura për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike mund të ndërrohet (plotësohet) kohë pas kohe, por ndryshimet (plotësimet) e tilla duhet të aprovohen nga Rregullatori.

#### **Neni 15**

##### **Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes**

1. I Licencuari do të jetë përgjegjës për funksionimin, sigurimin e mirëmbajtjes së Sistemit të Shpërndarjes, dhe nëse është e nevojshme, edhe zhvillimin e tij në përputhje me Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes si dhe me standarde të tjera të planifikimit dhe operimit të cilat i Licencuari mund t'i zbatoj, pas aprovimit nga Rregullatori
2. I Licencuari do të shqyrtojë kohë pas kohe zbatimin e Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes, dhe do të dorëzoj në Rregullator:
  - 2.1. një raport të rezultateve të këtij shqyrtimi; dhe
  - 2.2. propozimin për amendamentim eventual të Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes.

3. Rregullatori mund të lëshoj udhëzime që i kërkojnë të Licencuarit të rishikoj Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes, në mënyrën që specifikohet në Udhëzime.
4. I Licencuari do t'i publikoj Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes në faqen e tij zyrtare elektronike.

#### **Neni 16** **Standardet e Sigurisë së Operimit**

1. I Licencuari brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e aprovimit të modifikimit të kësaj licence, do të hartoj Standardet e Sigurisë së Operimit dhe do t'i dorëzoj në Rregullator për aprovim.
2. I Licencuari do t'i zbatoj Standardet e Sigurisë së Operimit dhe do të jetë përgjegjës për funksionimin e sistemit të shpërndarjes në përputhje me këto Standarde.
3. I Licencuari do ti rishqyrtoj herë pas here Standardet e Sigurisë së Operimit si dhe zbatimin e tyre, dhe do të dorëzojë në Rregullator:
  - 3.1. raportin mbi rezultatet e rishqyrtimit të tillë, dhe
  - 3.2. ndryshimet që propozohen t'u bëhen Standardeve të Sigurisë së Operimit.
4. Rregullatori mund të nxjerr udhëzime me të cilat kërkon nga i Licencuari që ti rishikoj Standardet e Sigurisë së Operimit në atë mënyrë që do të specifikohet në ato udhëzime, dhe i Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me ato udhëzime.
5. I Licencuari do t'i publikoj Standardet e Sigurisë së Operimit në faqen e tij zyrtare elektronike.

#### **Neni 17** **Standardet e Cilësisë së Furnizimit dhe Shërbimit të Operatorit të Shpërndarjes**

1. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me të gjitha standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike të aprovuar nga Rregullatori.
2. Kur Rregullatori kërkon, apo kur i Licencuari e konsideron të arsyeshme, i Licencuari do të shqyrtoj standardet ekzistuese të cilësisë së furnizimit dhe shërbimit, brenda afatit të përcaktuar nga Rregullatori.
3. I Licencuari do të zbatoj standardet e aprovuara dhe do t'i dorëzoj Rregullatorit për aprovim procedurat e monitorimit të përmbushjes së standardeve të cilësisë dhe furnizimit dhe shërbimit. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me procedurat e aprovuara.

4. I Licencuari do të dorëzoj në Rregullator çdo vit raport mbi ushtrimin e veprimtarisë lidhur me standardet që duhet përmbushur. Ky raport do të përfshijë informata dhe analiza lidhur me përmbushjen e standardeve sipas këtij Neni.
5. I Licencuari do të publikoj Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit, ashtu siç kërkohen nga Rregullatori, lidhur me përmbushjen ose mos përmbushjen e standardeve të përcaktuara sipas këtij Neni.

### **Neni 18**

#### **Qasja në Tokë dhe/ose në Ndërtesa**

1. I Licencuari do të ketë të drejtë të qasjes në tokë dhe/ose ndërtesa të palëve të treta ku kërkohet për kryerjen e aktiviteteve të tij të licencuara, në përputhje me Nenin 29 të Ligjit për Energjinë.
2. Brenda tre (3) muajsh nga hyrja në fuqi e kësaj licence, i Licencuari duhet të zhvilloj dhe të dorëzoj në Rregullator për aprovim Kodin e Punës, i cili përcakton parimet dhe procedurat që duhet të ndiqen në lidhje me ndonjë person që vepron në emër të të Licencuarit dhe që kërkon qasje në toke dhe/ose ndërtesa të ndërlidhura me kryerjen e aktiviteteve të licencuara.
3. Kodi i Punës do të përfshijë procedurat për të siguruar që personi që kërkon qasje në tokë dhe/ose ndërtesë, në emër të të Licencuarit:
  - 3.1. posedon aftësitë e nevojshme për të kryer detyrën e kërkuar;
  - 3.2. është trajnuar në mënyrë të duhur për Kodin e Praktikës të kompanisë, lidhur me premisat, tokën apo ndërtesat e palëve të treta.
  - 3.3. mund të identifikohet nga publiku, dhe
  - 3.4. janë persona të autorizuar për të vizituar dhe për të pasur qasje në premisa, tokë apo ndërtesa.
4. I Licencuari do të rishqyrtojë kohë pas kohe Kodin e Punës dhe çdo ndryshim i këtij Kodi do t'i nënshtrohet aprovimit të Rregullator.

### **Neni 19**

#### **Kufizimi në Përdorimin e Informatës së Caktuar**

1. I Licencuari, aty ku është e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve të licencuara, do të zbuloj çdo informacion, përveç atyre informatave konfidenciale, që i mban dhe/ose i ka siguruar gjatë kryerjes së funksioneve të veta si Operator i Sistemit të Shpërndarjes. Pavarësisht nga kjo, i Licencuari do t'i ofroj Rregullatorit çdo informatë që ajo mund të kërkoj lidhur me kryerjen e obligimeve që i janë dhënë me Legjislacionin në fuqi dhe Nenin 29 të kësaj Licence.

2. I Licencuari do të siguroj që çdo dokument që përmban informacione konfidenciale duhet ta bëjë identifikimin e qartë të informacionit si konfidencial (ta shënoj si informatë konfidenciale).
3. I Licencuari do të marrë masat e duhura, në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale, për të parandaluar zbulimin e informacioneve konfidenciale nga çdo person dhe këto informata nuk mund të përdoren apo zbulohen për ndonjë qëllim tjetër nga ajo që është dhënë sipas dispozitave përkatëse të ligjeve në fuqi.

#### **Neni 20**

#### **Dhënia e Informatave Operatorit të Sistemit të Transmetimit**

Në mënyrë që të sigurojë operim efikas, zhvillim të koordinuar dhe ndërfunksionim të sistemeve të ndërlidhura, i Licencuari do t'i dërgoj çdo informatë të nevojshme Operatorit të Sistemit të Transmisionit në atë mënyrën dhe kohën që arsyeshëm kërkohet nga ai operator.

#### **Neni 21**

#### **Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**

1. I Licencuari, në përputhje me Nenin 27 të Ligjit për Energjinë Elektrike, do të hartoj programin e pajtueshmërisë i cili përcakton masat të cilat duhet të ndërmerren për shthurjen e aktivitetit të shpërndarjes nga aktivitetet e tjera që nuk janë të lidhura me shpërndarjen, sa i përket formës ligjore, organizative dhe vendimmarrëse. Rregullatori duhet të miratoj një program të tillë.
2. Programi i përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni gjithashtu do të përcaktoj masat për eliminimin e sjelljeve diskriminuese dhe do të siguroj që programi të monitorohet në mënyrën e duhur.
3. Programi do të përcaktoj detyrimet specifike të punonjësve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për arritjen e objektivave të përmendura më lartë. Një raport vjetor publik i cili përshkruan masat të cilat janë ndërmarrë do të dorëzohet nga personi ose organi përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë në Zyrën e Rregullatorit për Energji.
4. I Licencuari do të publikoj Programin e Pajtueshmërisë në faqen e tij zyrtare elektronike.

#### **Neni 22**

#### **Përgjegjësia ligjore dhe menaxheriale**

1. Për të siguruar pavarësinë e të Licencuarit, në përputhje me Nenin 27.5 të Ligjit për Energjinë Elektrike, duhet të zbatohen kriteret e mëposhtme minimale:

- 1.1 personat përgjegjës për menaxhimin e të licencuarit nuk duhet të jenë pjesëmarrës në strukturën e ndonjë ndërmarrjeje përgjegjëse, në mënyre direkte apo të tërthortë, për kontrollin operacional të përditshëm të ndërmarrjes së përfshirë në prodhimin, transmetimin dhe furnizimin me energji elektrike;
- 1.2 i Licencuari duhet të ndërmarr të gjitha masat për të siguruar se interesat profesionale të personave përgjegjës për menaxhimin e një të Licencuari janë marrë parasysh në një mënyrë që siguron se ata janë në gjendje të veprojnë në mënyrë të pavarur.
2. Brenda tre (3) muajve të hyrjes në fuqi të kësaj licence, i Licencuari duhet të zhvilloj dhe dorëzoj në Rregullator për miratim Kodin e Sjelljes për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, duke specifikuar masat e nevojshme për të siguruar ndalimin e sjelljes diskriminuese. Ky kod duhet poashtu të përmbaj obligime specifike të drejtorëve dhe punëtorëve të tjerë, në çështje të lidhura me konfidencialitetin, konfliktin e interesit etj.
3. I Licencuari duhet që kohë pas kohe të rishikoj Kodin e Sjelljes dhe çdo ndryshim i këtij Kodi duhet të i dorëzohet Rregullatorit për miratim.
4. I Licencuari duhet të publikoj Kodin Sjelljes, të miratuar, në faqen e tij zyrtare elektronike.

### **Neni 23** **Rregullat e Tregut**

I Licencuari do të veprojë në pajtim me Rregullat e Tregut në fuqi.

### **Neni 24** **Shëndeti dhe Siguria**

1. I Licencuari do të ndërmarr të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur personat nga lëndimet që mund t'u shkaktohen atyre nga ana e të Licencuarit gjatë kryerjes së aktivitetit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryej kontrole (auditime) teknike dhe të sigurisë të sistemit të shpërndarjes në baza vjetore, dhe rezultatet e një kontrolli të tillë do t'i dërgoj në Rregullator, sa herë që kërkohet nga Rregullatori.

### **Neni 25** **Puna**

Lidhur me marrëdhënien dhe sigurinë në punë, i Licencuari do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

**Neni 26**  
**Obligimi i Sigurimit**

1. I licencuari do të bëjë sigurimin e të gjitha asetëve në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
2. I licencuari do të lidhë kontrata për sigurimin e asetëve të sistemit të shpërndarjes dhe për pajisjet që përdoren për shpërndarje të energjisë elektrike. Kontratat e tillë duhet të dorëzohen në Rregullator për rishikim në baza vjetore.

**Neni 27**  
**Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit**

1. I Licencuari do të njoftojë Rregullatorin për ndonjë ndryshim që pritët në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa Rregullatori nuk e aprovon atë.
2. I Licencuari do të njoftojë Rregullatorin për ndonjë ndryshim të Strukturës Organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet Rregullatorit jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

**Neni 28**  
**Obligimet e Shërbimit Publik**

1. I Licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimit publik që mund t'i vendoset nga Rregullatori, sipas Nenit 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
2. Aty ku Vendimi i Rregullatorit, që imponon obligime të Shërbimit Publik mbi të licencuarin, vendos kushte për heqjen e atij obligimi, atëherë kushtet e tilla duhet të konsiderohen pjesë përbërëse e kësaj licence.

**Neni 29**  
**Sigurimi i Informacioneve ndaj Rregullatorit**

1. I Licencuari do t'i dorëzoj Rregullatorit informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që Rregullatori mund t'i konsiderojë të nevojshme.
2. I Licencuari do të dorëzojë në Rregullator raporte mbi veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si dhe pajtueshmërinë me kushtet Licencës, në pajtim me Doracaku e Raportimit për Sektorin e Energjisë, të miratuar nga Rregullatori, si dhe kërkesave të Rregullatorit.
3. Nëse i Licencuari, në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale, kërkon që një informacion i caktuar të konsiderohet si konfidencial atëherë është obligim i tij që të shënjoj atë informacion si konfidencial dhe të arsyetoj kërkesën e tij te Rregullatori.

Rregullatori do të shqyrtoj aplikacionin në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.

4. Rregullatori ka të drejtë të kërkojë nga i Licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
5. I Licencuari duhet t'i dërgojë Rregullatorit detajet për çdo ndryshim në informata që janë dërguar gjatë aplikimit për këtë licencë.

Në këtë Nen:

**"Informacioni"** - materiali në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshij çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga Rregullatori.

### **Neni 30 Taksat**

I Licencuari duhet t'i paguaj Rregullatorit taksa fillestare apo vjetore, siç përshkruhet në Rregullën për Taksat, të miratuar nga Rregullatori.

### **Neni 31 Vazhdimi, Modifikimi Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës**

1. Rregullatori mund të vazhdoj, modifikoj, pezulloj, dhe ndërpres këtë Licencë, në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. Rregullatori mund të transferoj këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, por duke u siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të një transferimi të tillë.

### **Neni 32 Masat Administrative dhe Gjobat**

1. Në rast shkejeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi përfshirë rregullat e nxjerra nga Rregullatori apo nenet dhe kushtet e kësaj licence apo instruksioneve që Rregullatori i ka dhënë të Licencuarit, Rregullatori ka kompetenca t'i vendos të Licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe



personave përgjegjës brenda ndërmarrjes.

3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

### Neni 33

#### Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me Nenin 17 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga Rregullatori.
2. Vendimet e Rregullatorit lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të kontestohen nga i Licencuari në gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.

### Neni 34

#### Hyrja në fuqi

1. Në pajtim me Nenin 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë e ndryshuar/modifikuar tani me numër licence ZRRE/Li/Tr\_06/17 i lëshohet **“Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike” SH.A**, për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, dhe hynë në fuqi me datë **13.04.2017**.
2. Licenca e lëshuar me datë **04 Tetor 2006** (Nr. i Licencës ERO/Li\_06/06), e modifikuar me 18.07.2012 (Nr. i Licencës ZRRE/Li\_06/12), e transferuar me 01.03.2013 e që ka hyrë në fuqi me 03.05.2013 (Nr. i Licencës ZRRE/Li/Tr\_06/12), tani e modifikuar me 13.04.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Li/Tr\_06/17), do të vazhdoj të jetë e vlefshme për një periudhë tridhjetë (30) vjeçare, deri më **04 Tetor 2036**.

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji me: \_\_\_\_\_

Nënshkruar (në emër të Bordit të Rregullatorit) U.D Krenar Bujupi: \_\_\_\_\_

Nënshkruar më: 13.04.2017

